

VENDIM
Nr.1005, datë 9.7.2008

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR QENDRËN E PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet, për Qendrën e Publikimeve Zyrtare, për shpenzime korente, fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, në nënndarjen “Artikulli 602, “Mallra e shërbime””.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha